

Viti Shkollor _____

Informacion i Përgjithshëm mbi Arsimimin në Shtëpi në Nju Jork

- Kur arsimon fëmijën tuaj në shtëpi, ju (prindi ose kujdestari ligjor) bëheni përgjegjës për arsimimin e tij/saj. Kjo përfshin vendimmarrjen për lëndët që do të mësohen, përzgjedhjen e materialeve mësimore dhe orarin e të mësuarit. Mësuesit nga shkollat publike të NYC **nuk** ofrojnë mësim, dhe nxënësit që arsimohen në shtëpi **nuk marrin** burime si kompjuterë, libra mësimore apo qasje në shumicën e programeve të bazuara në shkollë, përfshirë sportet dhe aktivitetet jashtëshkollore.
- Nxënësit që arsimohen në shtëpi **nuk marrin** diplomë të Shtetit të Nju Jorkut, dhe diplomat nga shkollat që ofrojnë vetëm mësim online nuk njihen nga Shteti i Nju Jorkut. Megjithatë, programet online mund të përfshihen si pjesë e planit tuaj të arsimit në shtëpi (IHIP).

Udhëzime të Rëndësishme

- Vetëm prindi ose kujdestari ligjor mund të dorëzojë Letrën e Qëllimit (LOI). Dorëzimet nga palë të treta, përfshirë këshilltarët arsimorë apo mësuesit privatë, nuk do të pranohen.**
- Çdo vit, duhet të dorëzoni një Letër Qëllimi për çdo fëmijë që do të arsimohet në shtëpi, brenda 14 ditëve nga fillimi i arsimit në shtëpi.
- Fëmijët në NYC duhet të ndjekin shkollën ose të jenë të regjistruar në arsim në shtëpi nga mosha 6 vjeç deri në fund të vitit shkollor kur mbushin 17 vjeç. Nxënësit me një IESP aktiv (Individualized Education Services Plan) mund të vazhdojnë deri në moshën 21 vjeç.
- Pasi të dorëzoni Letrën e Qëllimit, **fëmija juaj do të çregjistrohet nga shkolla aktuale e DOE ose shkolla charter** dhe mund të fillojë arsimin në shtëpi. Megjithatë rekomandohet të informoni shkollën aktuale të fëmijës suaj, kjo nuk është e detyrueshme.

Si të Dorëzoni Letrën

Dorëzoni veçmas Letra Qëllimi (LOI) dhe dokumentet e kërkuara për çdo nxënëës në: letterofintent@schools.nyc.gov

Dokumentet e Kërkuara në Kohën e Regjistrimit

- Kopje e dokumentit të identifikimit të prindit/kujdestarit (patentë, pasaportë, etj.)
- Dokumente kujdestarie (nëse aplikohen)

Dokumente Shtesë të Kërkuara Nëse Jeni të Rinj në Shkollat Publike të NYC ose Po Përditësoni Informacionin (p.sh. ndryshim adrese)

- Dëshmi e moshës së fëmijës (certifikatë lindjeje, pasaportë ose certifikatë pagëzimi)
- Dëshmi banimi (faturë shërbimi, kontratë qiraje, etj.)
- Formulari Demografik për Arsimin në Shtëpi
- Pyetësori mbi Strehimin për Arsimin në Shtëpi (Homeschool Housing Questionnaire)

Për më shumë informacion dhe formularë, vizitoni faqen tonë të internetit në <https://www.schools.nyc.gov/enrollment/enrollment-help/home-schooling>

Informacioni i Prindit/Kujdestarit Ligjor

Emri i Prindit/Kujdestarit Ligjor (Mbiemër, Emër):	
Adresa e Plotë (përfshirë Nr. e Apartamentit):	
Qyteti, Shteti, Kodi Postar:	
Numri i Telefonit	E-mailit Adresa e

Informacioni i Nxënësit

Emri i Nxënësit (Mbiemër, Emër):	Data e Lindjes
ID e Nxënësit në NYC (nëse dihet):	A është ky nxënëës aktualisht i regjistruar në arsim në shtëpi? ☐ Po ☐ Jo
A ka ndjekur ndonjëherë ky fëmijë një shkollë publike/charter në NYC? ☐ Po ☐ Jo	
Nëse PO, emri ose numri i shkollës:	

Deklaroj se duke regjistruar fëmijën/fëmijët tim/të mi për arsim në shtëpi:

- Do të jem plotësisht përgjegjës për të gjithë mësimin e arsimit të përgjithshëm.
- Fëmija(t) im nuk do të ketë/në më qasje në mësimin në distancë, mësimin e përgjithshëm apo materiale mësimore.
- Fëmija(t) im/imë do të çregjistrohet/në nga shkolla e tyre aktuale në DOE ose shkolla charter.

E kuptoj se duhet të respektoj [Pjesën 100.10 të Rregulloreve Arsimore të Shtetit të Nju Jorkut](#).

Nënshkrimi i Prindit/Kujdestarit Ligjor: _____

Data: _____